



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1541/Prot.

Tiranë, më 30/12/2016

Lënda : Mendim për projektvendimin “Për miratimin në parim të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për rritjen e bashkëpunimit për të parandaluar udhëtimin e terroristëve dhe për të luftuar migracionin e paligjshëm dhe krimet e rënda që lidhen me to”.

Drejtuar: **Z. Saimir TAHIRI**

MINISTËR

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

I nderuar Z. Tahiri,

Referuar projekt-memorandumit të dërguar për mendim, vlerësojmë se në tërësi plotëson kërkesat bazë ligjore të sanksionuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Shkëmbimi i të dhënave personale midis Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës konsiderohet transferim ndërkombëtar i të dhënave personale, sipas përkufizimit në pikën 22 të nenit 3 të ligjit. Pavarësisht faktit që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konsiderohen si shtet me një nivel jo të mjaftueshëm mbrojtjeje të të dhënave personale (Vendimi i Komisionerit nr. 8, datë 31.10.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”), ky transferim ndërkombëtar legjitimohet sipas nenit 8/2/a, 8/2/dh të ligjit.

Ndërkohë që ky memorandum shërben për autoritetet publike kompetente në përmbushje të synimeve të tyre të ligjshme, një sërë kushtesh duhen përmbushur, me qëllim që impakti në privatësi të jetë i lejueshëm dhe i pranueshëm në raport me mbrojtjen e të dhënave.

Në këtë këndvështrim, do t’ju sugjeronim:

- Në pikën 1/c të memorandumit, në përmbajtje të përkufizimit të termit “Të dhëna personale”, është e nevojshme që të specifikohen kategoritë e të dhënave personale që do të shkëmbehen midis autoriteteve kompetente të të dyja vendeve;

- Referuar pikës 4 të memorandumit, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave, është e nevojshme që përpunimi i automatizuar i të dhënave personale të ofrojë mundësinë teknike të gjurmueshmërisë (çdo veprim të lërë gjurmë). Gjithashtu, në vijim të përmbajtjes së shkronjës c të kësaj pike, të shtohet togfjalëshi “Masat e sigurisë teknike për garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave në të gjitha fazat e përpunimit”. Përcaktimi i masave të sigurisë është një detyrim sipas nenit 27 të ligjit dhe nenit 7 të Konventës 108 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”. Masat e sigurisë duhet të jenë proporcionale;
- Në vijim të pikës 8/a të memorandumit është e nevojshme të përcaktohet legjislacioni mbi bazën e të cilit do të garantohet përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave. Në këtë kuadër, vlerësojmë se do të ishte më e logjikshme që të zbatohet legjislacioni i vendit, të cilit i përkasin të dhënat;
- Në pikën 8/b/i, në vijim të shtohet fjalia me përmbajtje si vijon: “Çdo pjesëmarrës duhet t’i përpunojë të dhënat personale vetëm për qëllimet që parashikohen në këtë memorandum”;
- Në pikën 8/b/ii parashikohet mundësia që të dhënat personale ruhen edhe për qëllime të tjera. Në këtë kuadër me qëllim që ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të jetë në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, duhet që të specifikohen se cilat janë “qëllimet e tjera”.
- Në pikën 10, është e nevojshme që të përcaktohet një periudhë/afat për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale nga pjesëmarrësit (në zbatim të nenit 5/1/d të ligjit). Përcaktimi i këtij afati duhet të kryhet në përputhje me qëllimin e përpunimit të të dhënave dhe për sa kohë ai ekziston.

Në përfundim, përmbajtja e memorandumit implementon parimet e mbrojtjes së të dhënave personale (sipas nenit 5 të ligjit) dhe në të njëjtën kohë përpunimi i të dhënave kryhet për interesa publike dhe qëllime të ligjshme siç është siguria nga terrorizmi dhe shmangia e emigracionit të paligjshëm.

Ju falënderoj për bashkëpunimin,

